

NOTË INFORMUESE

Mbi kërkesën për procedim disiplinor me masën ‘Shkarkim nga detyra’ për magjistraten Z.V.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates Z.V., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkak të dënimit për kryerjen e veprës penale të “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit, dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç Kodit Penal.

Hetimi disiplinor i kryer nga inspektorët e ILD-së konkludoi se:

- Gjyqtarja është gjetur fajtores nga Gjykata e Posaçme Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal dhe dënuar me 2 vjet burgim, konvertuar në 2 vite me kusht dhe heqje të së drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vitesh.
- Referuar fakteve dhe rrethanave të pranura nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykata e Posaçme e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, rezulton se: “...vepra penale është kryer me motiv kryesor kërkimin të përfitimit të parregullt monetar përkundrejt kryerjes së një veprimi, për të zbutur masën e dënimit për një shtetas, nga gjyqtare Z.V.”
- Ushtrimi i parregullt i detyrës nga ana e magjistrates, edhe për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, ka diskredituar rëndë figurën, autoritetin, dinjitetin si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë ka diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, si dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

Raporti hetimor i ILD konkludon se shkelja disiplinore e kryer është aq e rëndë, sa e bën magjistraten të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e saj dhe i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor, pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin ndaj magjistrate Z.V. të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.